

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6966
E premte, 11 gusht 2023
Çmimi 0.40 €

Instituti Octopus:
Bashkatdhetarët gjatë
kalimit nëpër Serbi
po pyeten për zhvillimet
në Kosovë | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

VRASJA E TRETË BRENDË NJË JAVE NË KOSOVË | FAQE 4-5

OPOZITA DHE SHOQËRIA CIVILE THONË SE SIGURIA PUBLIKE PO SFIDOHET NGA VRASJET



Një vrasje e rëndë ka ndodhur të enjten në orët e hershme të mëngjesit në një kafene në Runikë të Skenderajt, në të cilën ka mbetur i vrarë një person dhe tre të tjerë janë plagosur. Autoritetet e sigurisë kanë theksuar se janë

duke punuar për identifikimin dhe arrestimin e kryesve të këtyre veprave. Ky rast e çon në tre numrin e vrasjeve të raportuara në javën e fundit në Kosovë. Opozita dhe shoqëria civile kanë theksuar se vrasjet e shpeshta janë

tronditëse dhe po e bëjnë jetën të frikshme në Kosovë. Sipas tyre, siguria publike po sfidohet nga vrasjet e fundit dhe u kanë bërë thirrje qeverisë dhe policisë të ndërmarrin veprime për t'i parandaluar vrasjet

DËMET NGA SHIU UA VËSHTRËSOJNË TRAJTIMIN NË ONKOLOGJI PACIENTËVE ME KANCER | FAQE 7



BE-JA: HAPAT E QEVERISË SË KOSOVËS NË VERI, NË DREJTIMIN E DUHUR, POR DUHEN VEPRIME SHITESË | FAQE 3



AKTUALE



KURTI I BËN THIRRJE BE-SË PËR HEQJEN E MASAVE NDAJ KOSOVËS "SA MË SHPEJT" | F. 5

HAXHIU DORËZON NË QEVERI KONCEPT-DOKUMENTIN PËR THEMELIMIN E GJYKATËS ADMINISTRATIVE | F. 7

PËRKUJTOHET HEROI BEDRI SHALA | F. 6



EKONOMI



ZKA-ja: HUMBJA MESATARE E UJIT GJATË VITIT 2021 ISHTE 55 PËR QIND | F. 8

ATK-JA VERIFIKON MALLRAT PA ORIGJINË | F. 8

SPORT



ADEMI NË PODUJEVË: KËNAQËSI TË SHIHJA DASHAMIRË TË FUTBOLLIT | F. 10

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANJIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Spajiq shpallet mandatar për formimin e Qeverisë së Mal të Zi

Podgoricë, 10 gusht - Presidenti i Malit të Zi, Jakov Millatoviç, e ka zgjedhur liderin e partisë Evropa Tani, Millojko Spajiq, mandatar për kryeministër dhe formim të qeverisë së re. Ai e ka marrë këtë vendim dy muaj pas mbajtjes së zgjedhjeve të përgjithshme në këtë shtet. Spajiq i ka tani 90 ditë për të formuar koalicionin dhe për ta

formuar qeverinë. “Pres përgjegjësi dhe përshtatshmëri nga Spajiq, dhe të gjithë aktorët politikë që marrin pjesë në negociatat për formim të qeverisë. Besoj se në këtë moment Mali i Zi ka nevojë për qeveri stabile, të pandarë nga profili evropian”, ka thënë Millatoviç. Partia Evropa Tani ka dalë e para

në zgjedhjet parlamentare të qershorit. Përbërja e qeverisë në ardhje do të ofrojë një pasqyrë të asaj se kah do të drejtohet ky vend, ndonëse vazhdimisht përmendet synimi për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Zgjedhjet e qershorit janë mbajtur vetëm disa muaj pasi

udhëheqësia politike e Malit të Zi është goditur nga humbja e ish-presidentit Millo Gjukanoviç në raundin e dytë të zgjedhjeve presidenciale të prillit. Prej formimit të saj më 2022, partia Evropa Tani është zotuar për ta çuar përpara platformën pro evropiane dhe është zotuar për rritje të pagave e kryerje të reformave.



Polonia planifikon dërgimin e rreth 10 000 ushtarëve në kufi me Bjellorusinë



Varshavë, 10 gusht - Polonia është duke planifikuar të dërgojë rreth 10 000 ushtarë shtesë në kufi me Bjellorusinë për ta mbështetur Gardën Kufitare, ka thënë ministri polak i Mbrojtjes, Mariusz Blaszczak. “Rreth 10 000 ushtarë do të jenë në kufi, prej të cilëve 4 000 do ta mbështesin Gardën Kufitare dhe 6 000 do të jenë rezervë”, ka thënë ministri në një intervistë për radion publike. “Ne do ta afrojmë ushtrinë më afër kufirit me Bjellorusinë për ta dëbuar

agresorin, ashtu që të mos guxojë të na sulmojë”, ka thënë Blaszczak. Zëvendësministri i Brendshëm, Maciej Wasik, ka thënë të mërkurën se Polonia do t'i dërgojë 2 000 trupa shtesë në kufi me Bjellorusinë. Polonia është e shqetësuar për kufirin e saj, prej kur qindra pjesëtarë të grupit mercenar rus Wagner kanë arritur në Bjellorusi muajin e kaluar, me ftesë të liderit të shtetit, Alexander Lukashenko.

Të paktën 36 persona të vdekur nga zjarret në Havai

HAVAI, 10 GUSHT - Të paktën 36 persona kanë vdekur si pasojë e zjarreve pyjore që kanë përfshirë ishullin Maui në Havai, kanë thënë zyrtarët.

Zjarret janë ndezur nga erërat e forta - prej një uragani në afërsi - duke shkatërruar qindra ndërtesa dhe duke djegur shumë zona.

Mijëra persona janë detyruar të evakohen nga shtëpitë e tyre, pasi në zonën e zjarreve është shpallur gjendje e jashtëzakonshme.

Ekipet e kërkim-shpëtimit janë duke kërkuar për shumë persona të zhdukur. “Ne mezi ikëm me kohë”, ka thënë Kamuela Kawaakoa, e cila ka ikur në një

qendër evakuimi të enjten, bashkë me burrin dhe djalin e saj gjashtëvjeçar. “Ka qenë shumë e vështirë kur e kam parë vendin tim krejt në hi, dhe nuk kam mundur të bëj asgjë”.

Pesë qendra evakuimi janë hapur në Maui, por zyrtarët kanë thënë se të gjitha janë të mbingarkuara me njerëz.

Ky ishull vizitohet shumë nga turistët, por atyre u është bërë thirrje që të mos nisen atje. “Këtu nuk është vend i sigurt”, ka thënë guvernatorja e Havait, Sylvia Luke.

Zjarrfikësit janë ende në luftë me zjarret, ndërsa helikopterët janë duke hedhur ujë mbi zjarret nga lartësia.



Spanja po përballet me valën e katërt të të nxehtit

Madrid, 10 gusht - Spanja është duke u përballur me valën e katërt të të nxehtit këtë verë, pasi të mërkurën ka regjistruar temperaturën 44 gradë celsius.

Televizioni spanjoll RTVE ka raportuar për të nxehtë “ngufatës”, derisa në ballinën e

të përditshmes spanjolle “El Mundo” titulli kryesor ka qenë: “Neuronet po shkrihen si gjalp”.

Për gjithë territorin, ose pjesë të mëdha të rajoneve të Andaluzisë, Kastillës, Leonit, Madridit dhe Kastille-La Mançës, shërbimi shtetëror i

motit e ka vendosur nivelin më të lartë të alarmit.

Në Madrid, ku temperatura është regjistruar 40 gradë celsius pak para orës 19:00, shumë rrugë janë boshatisur. Sipas meteorologëve, vala e të nxehtit do të nisë të dobësohet të premtën.



BE-ja: Hapat e Qeverisë së Kosovës në veri, në drejtimin e duhur, por duhen veprime shtesë

PRISHTINË, 10 GUSHT - Bashkimi Evropian tha të enjten se Qeveria e Kosovës duhet të hedhë hapa shtesë për uljen e tensioneve në komunat veriore të banuara me shumicë serbe dhe se blloku është i gatshëm të vendosë masa ndëshkuese edhe ndaj Serbisë nëse ajo nuk ndërmer veprime në këtë drejtim. Duke komentuar letrën që dhjetëra ligjvënës euro-perëndimorë ua dërguan zyrtarëve të lartë të Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Evropian për ndryshimin e qasjes ndaj Kosovës dhe Serbisë, zëdhënësi i bllokut, Peter Stano, tha se politikën e jashtme të Bashkimit Evropian e përcaktojnë vendet anëtare të tij. "E tëra që mund të them sa i takon kësaj çështjeje të ngritur nga 56 nënshkrues, parlamentarë nga disa vende anëtare dhe disa vende të treta, është se politikën e Bashkimit Evropian vendosen njëzëri nga 27 vendet anëtare, siç është e përcaktuar dhe siç

kërkohe nga qeveritë e tyre. Kemi mijëra e mijëra parlamentarë në Bashkimin Evropian kështu që pozicioni dhe veprimet e Bashkimit Evropian rreth politikës së jashtme përcaktohen unanimisht nga vendimet e 27 qeverive", tha Stano.

Letra e nënshkruar nga dhjetë kryetarë të komisioneve për marrëdhënie me jashtë dhe 56 deputetë kërkon diplomaci parandaluese, baraspeshë dhe mospërsëritje të gabimeve të së kaluarës, ndërsa thekson mungesën e trysnisë ndaj Serbisë pas tensioneve në veri të Kosovës. Stano tha se qasja e Bashkimit Evropian është e paanshme. "Ajo që kemi bërë më së fundi në dritën e përshkallëzimeve që ndodhën është vendosja e disa masave kundër Qeverisë së Kosovës për shkak të paaftësisë për të vepruar në një mënyrë evropiane drejt shtensionimit dhe marrjes së hapave të rëndësishëm në këtë drejtim", tha Stano, duke theksuar



se "nëse vendet anëtare kërkojnë diçka të tillë, ne do t'i vendosim masat e nevojshme edhe kundër Serbisë nëse pra këto vende anëtare vlerësojnë se në kushtet dhe kontekstin aktual të krizës së fundit Serbia nuk po bën asgjë për t'i ulur tensionet", tha ai.

Tensionet u rritën në fund të muajit maj kur kryetarët shqiptarë të komunave veriore të Kosovës morën detyrën me mbështetjen e policisë, pas zgjedhjeve lokale të

muajit prill, të cilat u bojkotuan nga serbët, që kërkojnë zbatimin e një marrëveshjeje të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian për më shumë vetëqeverisje.

Zëdhënësi Stano vlerësoi se të gjitha masat janë të kthyeshme dhe varen nga mënyra se si Prishtina e Beogradi i qasen shtensionimit dhe kthimit në procesin e rregullt të bisedimeve. Pas një pajtimi të arritur më 10

korrik në Bratislavë në një takim ndërmjet kryenegociatorit të Kosovës, Besnik Bislimi dhe të dërguarit evropian për bisedimet Kosovë - Serbi, Miroslav Lajčak, Policia e Kosovës tashmë ka përgjysmuar praninë e saj në dhe rreth ndërtesave të komunave në veri.

Qeveria e Kosovës është vënë në përpjekje për ta siguruar bazën ligjore për mbajtjen e zgjedhjeve, duke hartuar një dokument që do t'u mundësonte qytetarëve të komunave shkarkimin e kryetarëve të tyre përmes një peticioni.

Në një përgjigje dhënë Zërit të Amerikës nëpërmjet postës elektronike Bashkimi Evropian tha se e mirëpret njoftimin e fundit të Qeverisë së Kosovës për një ulje të pranish policore brenda dhe përreth ndërtesave komunale në veri të Kosovës. "Këta janë hapa në drejtimin e duhur, por nevojiten hapa të mëtejshëm", thuhet në përgjigje. (Voa)



Instituti Octopus: Bashkatdhetarët gjatë kalimit nëpër Serbi po pyeten për zhvillimet në Kosovë



Prishtinë, 10 gusht - Instituti Octopus ka bërë me dije se disa bashkatdhetarë e kanë njoftuar se në kufirin me Serbinë autoritetet serbe kanë shprehur interesim të veçantë për zhvillimet në Kosovë.

Në "Facebook" ky Institut u ka bërë thirrje qytetarëve të mos bien pre e provokimeve të autoriteteve të Serbisë. "Në Institutin Octopus disa bashkatdhetarë kanë treguar se në kufirin me Serbinë autoritetet serbe kanë shprehur interesim të veçantë për zhvillimet në Kosovë, veçmas për pjesëtarë

të UÇK-së dhe institucionet e sigurisë. Në këto raste, duke marrë parasysh se asgjë nuk i obligon qytetarët tanë të flasin, as ligjet e Serbisë, u bëjmë thirrje që mos të përgjigjeni në këto kërkesa, që kanë për qëllim vetëm pajisjen me informacion pa paguar asgjë. Qytetarët të mos bien pre e provokimeve të autoriteteve të Serbisë, që përmes kurtheve të ndryshme, deklaratave dhe pohimeve të rreme, synojnë t'i zhytin për të ofruar të dhëna apo bashkëpunuar me ta", bëhet me dije në njoftim. Sipas Octopusit, në këto

raste qytetarët, nëse eventualisht pyeten për gjëra të tilla, të kërkojnë arsye pse po ndalen dhe ta kërkojnë praninë e avokatit të kërkojnë të kuptojnë nëse janë të dyshuar për ndonjë veprë. "Përndryshe, nuk kanë asnjë obligim që të flasin! Të ndaluarit e mundshëm është mirë që rastet t'i paraqesin tek institucionet e Republikës së Kosovës, kurse ata që kanë shtetësi tjetër (të ndonjë vendi perëndimor), rastet t'i raportojnë edhe pranë autoriteteve të shteteve ku jetojnë", ka njoftuar Octopus.



VRASJA E TRETË BRENDA NJË JAVE NË KOSOVË

Opozita dhe shoqëria civile thonë se siguria publike po sfidohet nga vrasjet e fundit

Një vrasje e rëndë ka ndodhur të enjten në orët e hershme të mëngjesit në një kafene në Runikë të Skenderajt, ku ka mbetur i vrarë një person dhe tre të tjerë janë plagosur. Autoritetet e sigurisë kanë theksuar se janë duke punuar për identifikimin dhe arrestimin e fajtorëve për këtë vrasje. Ky rast e çon në tre numrin e vrasjeve të raportuara në javën e fundit në Kosovë. Opozita dhe shoqëria civile kanë theksuar se vrasjet e shpeshta janë tronditëse dhe po e bëjnë jetën të frikshme në Kosovë. Sipas tyre, siguria publike po sfidohet nga vrasjet e fundit dhe u kanë bërë thirrje qeverisë dhe policisë të ndërmarrin veprime për t'i parandaluar vrasjet

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 10 GUSHT - Një 39-vjeçar ka vdekur të enjten në Skenderaj si pasojë e të shtënave me armë zjarri, ka njoftuar Policia e Kosovës. Përmes një komunikate për medie, policia ka thënë se vrasja ka ndodhur në fshatin Runikë të Skenderajt dhe, përveç viktimës, në vend të ngjarjes janë plagosur edhe tre persona të tjerë. Ata është thënë se po trajtohen në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës. "Nga hetimet e para në vendin e ngjarjes, dyshohet se dy persona të dyshuar e të maskuar kanë hyrë brenda në kafene, kanë

shtënë me armë dhe janë larguar në drejtim të panjohur. Në cilësi të provave materiale, në vendin e ngjarjes janë gjetur dhe konfiskuar disa gëzhoja", ka thënë policia.

Autoritetet e rendit kanë theksuar se janë duke punuar për identifikimin dhe arrestimin e fajtorëve për këtë vrasje. Ky rast e çon në tre numrin e vrasjeve të raportuara në javën e fundit në Kosovë.

Drejtori i Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), Ismet Kryeziu, ka thënë se vrasjet e shpeshta janë tronditëse dhe po e bëjnë jetën të frikshme në Kosovë. "Institucionet e shtetit duhet të japin përgjigje, a janë të

parandalueshme këto ngjarje dhe çfarë po bëhet për t'i parandaluar ato? Cilat janë arsyet dhe shkaqet që këto vrasje janë bërë më të shpeshta dhe kanë marrë tendencë shqetësuese dhe të frikshme për sigurinë e qytetarëve?", ka shkruar Kryeziu në "Facebook". Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka theksuar se vendi është duke u përballur me sfida të shumta të sigurisë. Krahas qasjes së gabuar politike të qeverisë në veri të vendit e cila ka reflektim serioz edhe në siguri, lloje të ndryshme të kriminit e sidomos ato të rënda siç janë vrasjet, lëndimet e rënda trupore, armët pa leje, prania e

madhe e narkotikëve, janë disa nga aktivitetet e kundërligjshme të cilat po e cenojnë seriozisht jetën e qytetarëve. "Që nga shpallja e pavarësisë së vendit, institucionet e sigurisë kanë punuar me shumë përkushtim për avancimin e sigurisë publike duke hartuar dhe implementuar shumë strategji nacionale, plane konkrete operative të cilat, mbi të gjitha, kishin për qëllim parandalimin efikas të kriminit dhe dukurive të ndryshme negative në shoqëri. Nga viti në vit efikasiteti i Policisë së Kosovës prekte ndjenjën e sigurisë së qytetarëve duke shkurtuar në masë të madhe krimin në përgjithësi, në veçanti vrasjet dhe krimet e rënda", ka thënë Haradinaj.

Ai ka shtuar se qasja e gabuar e qeverisë dhe e MPB-së, duke zhvendosur elementin kyç në shoqëri, sigurinë publike, brenda agjendës së saj purpolitike, kanë bërë që elementet me prije kriminale të organizohen në banda të cilat sot cenojnë të papenguara jetën

e qytetarëve. "Fatkeqësisht siguria publike në vend tashmë është duke u sfiduar nga banda të armatosura të cilat nuk zgjedhin as cak e as vend për t'i terrorizuar qytetarët. Vrasjet në ditët e fundit, përfshirë edhe vrasjen e një shtetasi të huaj, janë treguesi më i mirë për pasigurinë dhe kërcënimin që u kanoset qytetarëve si në rrugë, po ashtu dhe në ambiente publike, lokale hoteliere e gjetiu", ka theksuar Haradinaj. Ai ka thënë se mungesa e vizionit dhe përkushtimit të qeverisë e MPB-së ngrit dyshime të shumta se ky nivel i lartë i cenimit të sigurisë publike dhe neglizhenca institucionale për t'i parandaluar këto lloje të krimeve nga të cilat çdo ditë është duke u tronditur vendi, ka për qëllim zhvendosjen e vëmendjes së opinionit nga skandalet dhe aferat e shumta korruptive të qeverisë, ku së fundmi u mësua edhe për planifikim të kontrabandës ndërkombëtare me armë nga ana e sekserëve të afërt me

Kurti i bën thirrje BE-së për heqjen e masave ndaj Kosovës "sa më shpejt"

PRISHTINË, 10 GUSHT - Mënyra më e duhur për shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme në katër komunat në veri është peticioni, thotë kryeministri Albin Kurti. Ai thekson se vetëm kur 20 për qind e trupit elektoral shpreh vullnetin për t'ua ndërprerë mandatin kryetarëve aktualë jepen dëshmi se nuk mund të ketë bojkot të pjesëmarrjes në zgjedhje, qoftë si votim apo kandidim.

Në anën tjetër, kreu qeveritar thotë se shpërshkallëzimi në veri në masë të madhe ka ndodhur, derisa kërkon nga Bashkimi Evropian që sa më parë t'i largojë masat ndëshkuese dhe ta përmirësojë qëndrimin ndaj Kosovës.

Kurti për KosovaPress thotë se po punojnë që sa më shpejt të bëhet rregullimi i çështjeve teknike dhe administrative për zgjedhjet e reja në veri. "Sa iu përket zgjedhjeve të reja të parakohshme, ne qysh në fillim

kemi thënë se nuk jemi të kënaqur me daljen e qytetarëve në zgjedhje më 23 prill të këtij viti dhe me ato çfarë mësuan si përqindje më 24 prill të nesërmen. Andaj kemi ofruar mundësinë që të kemi zgjedhje të parakohshme, por natyrisht dëshirojmë të mos na përsëritet situata në të cilën sërish do të kemi bojkot të pjesëmarrjes në zgjedhje, qoftë si votim apo si kandidim. Ne mendojmë se mënyra e duhur për këtë është duke shfrytëzuar nenin 72 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, i cili parasheh mundësinë e 20 për qind të trupit elektoral që të dalin dhe shprehin vullnetin e tyre për t'ua ndërprerë mandatin kryetarëve aktualë. Jemi të hapur për këtë. Është krijuar edhe një grup punues që do ta bëjë rregullimin e çështjeve teknike administrative të dispozitave të këtij neni dhe këtij ligji. Tash ta presim punën e tyre, sa më shpejt aq më mirë,

por edhe një herë po them nuk besoj se ka arsye më që të ketë ndokush dyshime se Kosova nuk është palë konstruktive. Përkundrazi ne jemi palë konstruktive që është dëshmuar me ide kreative dhe përkushtim për të gjetur zgjidhje", thotë Kurti.

Ai shton se Kosova është e interesuar për shpërshkallëzim të plotë në veri mirëpo, sipas tij, duhet të jenë të kujdesshëm nga mundësia e ri përkallëzimit të situatës atje. "Ne e kemi një grup punues tash që e bën vlerësimin e gjendjes së sigurisë. Policia e Kosovës konsultohet edhe me EULEX-in dhe me KFOR-in. Si rezultat i këtyre vlerësimeve të këtij grupi profesional ne dy herë nga 25 për qind e kemi zvogëluar praninë e policisë sonë në tri ndërtesat në tri komunat veriore të Kosovës. Jemi të interesuar për shpërshkallëzim të mëtutjeshëm, ndonëse është

konstatim i përgjithshëm se në masë të madhe shpërshkallëzimi tashmë ka ndodhur. Nuk kemi protesta të dhunshme, s'kemi incidente veçse duhet të jemi të kujdesshëm nga potencialiteti i ripërshkallëzimit. Dihet që adresa për këtë nuk ndodhet në Republikën e Kosovës, por në kryeqytetin e fqinjit tonë verior", deklaroi kryeministri Kurti.

Duke folur për masat ndëshkuese të Bashkimit Evropian ndaj Kosovës, kryeministri Kurti thotë se të njëjtat nuk janë fer dhe duhet të hiqen sa më parë. Sipas tij, BE-ja ta përmirësojë qëndrimin ndaj Kosovës. "Sa iu përket masave që janë marrë ndaj nesh, ne konsiderojmë se nuk janë fer. Janë pjesë e asimetrisë në raporte dhe sa më parë që të përfundojnë aq më mirë. Ne po bëjmë krejt çfarë mund dhe dimë, por do të duhej që edhe partnerët dhe aleatët tanë

evropianë sa më parë ta përmirësojnë qëndrimin e tyre ndaj Kosovës. Pasi një republikë demokratike dhe progresiste siç është Kosova meriton të ndihmohet me krejt çka mundën ata dhe jo të ketë masa ndëshkuese", thotë ai.

Në anën tjetër, Kurti e mirëpret edhe letrën e ligjvënësve evropianë dhe amerikanë, ku kërkohet mbështetje më e madhe ndaj Kosovës dhe qasje më e ashpër ndaj Serbisë. "Nëpër parlamentet e shteteve të perëndimit demokratik, Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, gjithnjë e më shumë ka ligjvënës, përfaqësues të popujve lirishtës dhe demokratikë të cilët dëshirojnë që qasja ndaj Kosovës të përmirësohet dhe ndaj Serbisë të ashpërsohet. Ne mendojmë se një iniciativë e tillë është e drejtë dhe dobishme", përfundon Kurti.



qeverinë. "Shfaqja e kriminelëve me maska siç ishte rasti i mbrëmshëm në komunën e Skenderajt, ku mbeti i vrarë një qytetar dhe u plagosën tre të tjerë, nxjerr në pah pafuqinë e qeverisë si dhe guximin e grupeve kriminale për të vepruar. Objektivisht qytetari ka mbetur i pambrojtur, i papërkujdesur nga kjo qeveri e

cila ka mungesë të madhe profesionale për të trajtuar çështje komplekse siç është siguria. Kjo qeveri do të mbahet përgjegjëse për përkeqësimin e gjendjes së sigurisë në vend. Mocioni është zgjidhja", ka thënë Haradinaj.

Kryetari i Komisionit për Siguri në Kuvendin e Kosovës, Bekë Berisha, ka thënë se ngritja e

nivelet të dhunës në ditët e fundit na ka shqetësuar të gjithëve tej mase. "Para se të gjejmë fajtorin dhe të flasim për fenomenin apo për defektet e mosefikasitetit të sistemit të sigurisë, rendit dhe drejtësisë në vendin tonë, i bëj thirrje drejtorit të policisë të dalë me plan konkret, duke ndërmarrë veprimet e duhura, që kjo gjendje të stabilizohet. Orë

policore", ka shkruar në "Facebook" deputeti Berisha. Në mbledhjen e 154-t të qeverisë kryeministri Albin Kurti ka folur për sistemin e drejtësisë në vend, duke theksuar se janë të shumta rastet kur, si pasojë e mosveprimit të sistemit të drejtësisë, persona të ndryshëm me precedentë të shumtë penalë lëvizin lirshëm, qoftë të liruar nga

organet apo edhe të pandjekur fare penalisht, e të cilët rrezikojnë dhe marrin jetën e qytetarëve tanë. Ai ka theksuar se reforma është domosdoshmëri e vetingu është zgjidhja. "Raporte të ndryshme kredibile vendore dhe ndërkombëtare konstatojnë se drejtësia jonë vazhdon të jetë joefikase dhe e ngadaltë", është shprehur Kurti.

Totaj: Buxheti i komunës duhet të ndërtohet me akterët e jetës publike dhe vet qytetarët

PRIZREN, 10 GUSHT- “Qeverisja lokale është shërbim publik, prandaj, buxheti i komunës duhet të ndërtohet me të gjithë akterët e jetës publike dhe vet qytetarët”, kështu u shpreh kryetari Shaqir Totaj në dëgjimet e para buxhetore në Qendrën Rinore në lagjen “Ortakoll”, ku së bashku me nënkryetarin Kujtim Gashi, kryesuesen e Kuvendit Komunal, Antigona Berisha-

Bytyqi, drejtorë të ekzekutivit, përfaqësues të shoqërisë civile dhe qytetarë, dëgjuan propozimet e kërkesat konkrete për nevojat në investime, qoftë në infrastrukturë apo edhe në subvencionime, për t’u përfshirë në planifikimin e buxhetit të vitit 2024. Dëgjimi publik buxhetor u mbajt me gra, të rinj, pensionistë, grupe të

qytetarëve nga komunitete të ndryshme, përfshirë komunitetin Boshnjak, Turk, Rom, Ashkali, Egjiptian dhe Goran, me biznese, fermerë dhe ndërtues të Komunës. Të gjitha kërkesat u regjistruan dhe sipas prioritetit e mundësive buxhetore do të realizohen, që do të ndikojnë në cilësinë e jetës në lagje, qytet e fshatra.



Komuna e Malishevës ka filluar mbajtjen e dëgjimeve publike për hartimin e buxhetit

MALISHEVË, 10 GUSHT - Komuna e Malishevës ka filluar organizimin dhe mbajtjen e dëgjimeve buxhetore për hartimin e projekt-buxhetit sipas Kornizës Afatmesme Buxhetore 2024-2026, me theks të veçantë për hartimin e buxhetit për vitin 2024. Për këtë qëllim, të enjten janë organizuar katër dëgjime buxhetore me sektorët apo grupe të ndryshme të interesit, ku janë përfshirë kryetarët e këshillave lokale në Malishevë, arsimit, shëndetësia, bizneset dhe organizatat joqeveritare. Draft-buxhetin komunal para të pranishmëve në këto takime e ka paraqitur drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Blerim Thaçi, me zyrtarët e kësaj drejtorie, i cili i ka njoftuar me buxhetin e planifikuar për komunën e Malishevës. Sipas drejtorit Thaçi, buxheti i planifikuar për vitin 2024 për komunën e Malishevës është



rreth 20 milionë euro, ndërsa për investime kapitale janë të planifikuara 6.2 milionë euro, po ashtu i ka njoftuar për ndarjet e tjera buxhetore, si mallra dhe shërbime, subvencione dhe nga kategoritë e tjera buxhetore. Pas njoftimit për buxhetin e planifikuar, pjesëmarrësit në këto dëgjime i kanë paraqitur kërkesat e tyre për hartimin e buxhetit, përkatësisht për orientimin e buxhetit të planifikuar për investime, në mënyrë që

investimet të krijojnë mirëqenie dhe zhvillim për komunën e Malishevës dhe për këtë qëllim edhe janë duke u mbajtur këto dëgjime publike. Në ditët në vijim dëgjimet apo konsultimet publike për hartimin e projekt buxhetit do të mbahen edhe nëpër fshatrat e komunës së Malishevës me qëllim të gjithëpërfshirjes së qytetarëve në hartimin dhe orientimin e buxhetit dhe investimeve për vitin 2024.

Përkujtohet heroi Bedri Shala

DRENAS, 10 GUSHT - Me rastin e shënimit të 25-vjetorit të rënies së heroit Bedri Shala, në fshatin Gjergjiçë është bërë zbulimi i pllakës përkujtimore shtëpi-bazë e UÇK-së, te vendlindja e heroit. Në zbulimin e pllakës përkujtimore ka marrë pjesë nënkryetari i komunës, Arben Shala, përfaqësuesi i familjes Jashari, Bekim Jashari, lideri i shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut, Ali Ahmeti, deputetë të Kuvendit, familjarë e shumë qytetarë. Në zbulimin e pllakës kanë folur nënkryetari Arben Shala, Ali

Ahmeti, deputeti Ferat Shala dhe Bekim Jashari. Ndërsa në orën 12:00 në sheshin “Fehmi Lladrovci” pranë shtatores së heroit Bedri Shala janë bërë homazhe dhe vendosur buqeta me lule të freskëta. Po ashtu, homazhe janë bërë edhe në Kompleksin e Varrezave të Dëshmorëve në Marinë dhe në pllakën përkujtimore në Junik. Në betejën e Junikut, në gushtin e vitit 1999, përballë forcave paramilitare serbe, kanë rënë heroikisht Bedri Shala, Bekim Berisha-Abeja, Permet Vula, Elton Zherka dhe Bashkim Leku.



Në Kamenicë mbahet tryeza për promovimin e të drejtave të komunitetit rom në jetën institucionale

Kamenicë, 10 gusht - Organizata joqeveritare Dardanapress, në kuadër të projektit “Promovimi i të drejtave dhe interesave të komuniteteve në komunën e Kamenicës”, ka mbajtur tryezën e parë lidhur me promovimin e të drejtave të komunitetit rom dhe pjesëtarëve të tyre në jetën institucionale. Qëllimi i organizimit të tryezës ishte diskutimi i sfidave dhe



problemeve që ballafaqohen qytetarët e komunitetit rom në jetën e përditshme, si dhe shqyrtimi i mundësive për ta

përmirësuar gjendjen nga institucionet komunale. Pjesëmarrësit gjatë diskutimeve kanë shprehur shqetësimet dhe

mendimet e tyre lidhur me pjesëmarrjen e qytetarëve të komunitetit rom në vendimmarrje, ku janë nxjerrë edhe disa konkluzione dhe rekomandime. Si rekomandime kryesore të dala nga tryeza janë: organizimi i kurseve për mësimin e gjuhës shqipe, rritja e punësimit të komunitetit rom në institucionet komunale, zgjidhja e problemeve sociale, të drejtat në

shkollim, të jenë aktivë në jetën kulturore dhe sportive, rritja e bashkëpunimit me komunat e tjera ku jeton komuniteti rom, ndarja e bursave për shkollim dhe studime etj. Ky projekt është financuar nga Zyra e Kryeministrit, Zyra për Çështje të Komuniteteve në kuadër të projektit “Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave dhe interesave të komuniteteve”.

Fillojnë punimet për ndërtimin e ballkonit panoramik dhe shtegut të ecjes në Mitrovicë

MITROVICË, 10 GUSHT - Në fshatin Zasellë të Mitrovicës është inauguruar fillimi i punimeve për ndërtimin e ballkonit panoramik dhe shtegut të ecjes. Në ceremoninë e fillimit të punimeve, i pranishëm ishte kryetari i komunës, Bedri Hamza, nënkryetari Arian Tahiri, kryesuesja e kuvendit, Vesa Broja, drejtori për

Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, Elvis Feka. Kryetari Hamza u shpreh i lumtur për fillimin e realizimit të këtij projekti, për të cilën tha se do të jetë nga vendet më të mira dhe më të frekuentuara në qytetin e Mitrovicës. Ndërsa drejtori Elvis Feka ka theksuar se ideja për realizimin e këtij projekti është iniciuar nga Drejtoria për

Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm dhe ka rëndësi të veçantë për zhvillimin e turizmit si dhe do të jetë një vlerë e shtuar për qytetin e Mitrovicës. Ky projekt po realizohet në kuadër të marrëveshjes së bashkëfinancimit në mes të komunës së Mitrovicës dhe Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, vlera e të cilit është 250 000.00 euro.



Haxhiu dorëzon në qeveri koncept-dokumentin për themelimin e Gjykatës Administrative

PRISHTINË, 10 GUSHT - Ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka bërë me dije se të enjten ka proceduar në Qeverinë e Kosovës koncept-dokumentin për themelimin e Gjykatës Administrative, në të cilin

adresohet edhe zgjidhja e kontesteve nga marrëdhënia e punës.

Haxhiu në "Facebook" ka shkruar se edhe një zotim i saj po përmbushet. "Sapo proceduam në qeveri koncept-

dokumentin për themelimin e Gjykatës Administrative, në të cilin adresohet edhe zgjidhja e kontesteve nga marrëdhënia e punës. Themelimi i gjykatës në fjalë përmbyllë krijimin e infrastrukturës ligjore në

fushën e drejtësisë administrative, rritë dukshëm efikasitetin e zgjidhjes së lëndëve dhe lehtëson qasjen e qytetarëve në drejtësi administrative", ka thënë Haxhiu.



Dëmet nga shiu ua vështirësojnë trajtimin pacientëve me kancer

PRISHTINË, 10 GUSHT - Reshjet e shiut fundjavën e kaluar shkaktuan dëme materiale në Klinikën e Onkologjisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës. Arsyeja? Kompanitë e kontraktuara për renovimin e kulmit të kësaj klinike nuk arritën t'i kryenin punimet me kohë.

Për pasojë, dokumentet e pacientëve janë dëmtuar, janë prishur disa kompjuterë, janë dëmtuar tavanet dhe muret e zyrave dhe dhomave të pacientëve që marrin trajtim për lloje të ndryshme të kancerit në Onkologji. Më 7 dhe 8 gusht ekipi i Radios Evropa e Lirë vizitoi këtë klinikë dhe pa nga afër dëmet e shkaktuara nga shiu. Në kohën kur po bëhej sanimi i dëmeve, nën zhurmën e sharrave e çekanëve, pacientët po merrnin terapitë e tyre kundër kancerit. "Po na pengon [zhurma] pak, por çka të bëjmë. Edhe ata duhet të punojnë", tha për Radion Evropa e Lirë një paciente e shtrirë në katin e dytë të Onkologjisë.

Shiu shkaktoi dëme edhe në kuzhinën e klinikës, nga e cila

shpërndahet ushqimi për pacientët.

Shiu që depërtoi në klinikë ka prekur edhe kabinetin e citostatikëve, aty ku përgatitet terapia për pacientët që trajtohen me kimioterapi. Kjo ka detyruar stafin ta ndryshojë vendin e materialit për përgatitjen e terapisë për pacientët me kancer.

Në një prej dhomave, ku pacientët marrin terapinë, për shkak të rrjedhjes së vazhdueshme të ujit, janë larguar dy shtretër të pacientëve.

Për renovimin e kulmit të Onkologjisë janë angazhuar dy kompani private. Të pyetur për punën dhe dëmet e shkaktuara në klinikë, përfaqësuesit e kompanisë nënkontraktuese sqaruan se deri te depërtimi i ujit në klinikë erdhi për shkak se kompania kryesore, që ka fituar tenderin për renovim, nuk ka arritur me kohë ta sjellë materialin për mbulimin e kulmit, prandaj janë shkaktuar dëmet fundjavën e kaluar.

Por, kompania kryesore, në komunikimet që ka pasur me



zyrtarët përgjegjës, ka thënë se masat paraprake mbrojtëse janë marrë, por dëmet u shkaktuan për shkak të erërave të forta.

Mbikëqyrja e punimeve në kulmin e Onkologjisë është nën përgjegjësinë e Ministrisë së

Ekonomisë.

Njomzaj Blakaj, menaxhere e projektet të efikasitetit të energjisë, tha për REL-in se në kontratën e punimeve është specifikuar se të gjitha dëmet eventuale të shkaktuara gjatë

ndërtimit do t'i marrë përsipër kompania që e ka fituar tenderin. "Kompania ndërtuese, pas gjendjes së krijuar, ka thënë se do t'i bëjë të gjitha sanimet e dëmeve të shkaktuara", tha Blakaj. Të njëjtën gjë e kanë konfirmuar edhe përfaqësuesit e kompanive ndërtuese.

Drejtorja e Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës (ShSKUK) po pret që të bëhet vlerësimi i saktë i dëmeve. "Presim të bëhet një vlerësim i saktë i dëmeve dhe të rregullohen sa më parë", tha një nga drejtorët në ShSKUK.

Në Klinikën e Onkologjisë, tashmë e dëmtuar nga reshjet e shiut, që nga fillimi i vitit e deri në muajin korrik janë kontrolluar 30 000 persona. Deri po atë muaj janë konfirmuar 1 224 raste të reja me kancer. Në këtë klinikë në vitin 2022 ishin kontrolluar apo kishin marrë shërbime 47 351 persona, ndërkaq 1 736 ishin raste të reja.

Klinika e Onkologjisë në Prishtinë është e vetmja qendër në Kosovë, ku të prekurit me kancer marrin kimioterapinë apo trajtime të tjera të nevojshme për ta. Brenda 24 orëve aty mesatarisht marrin shërbime rreth 400 pacientë, që vijnë nga qytete të ndryshme të Kosovës. Shpeshherë pacientët aty presin në radhë me orë të tëra për të gjetur shtrat për të marrë kimioterapi.



Të hënën fillon punimet Seminari XLI Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare

Prishtinë, 10 gusht - Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare

do t'i nisë punimet të hënën, më 14 gusht. Rreth 150 studentë dhe studiues të shkencave

albanologjike nga vende të ndryshme të botës nga 14 deri 25 gusht 2023 do të qëndrojnë në

Prishtinë dhe gjatë këtyre ditëve do t'i ndjekin kurset e mësimi të gjuhës shqipe si dhe

do t'i shpalojnë hulumtimet e tyre shkencore në fushën e albanologjisë.

ZKA-ja: Humbja mesatare e ujit gjatë vitit 2021 ishte 55 për qind

PRISHTINË, 10 GUSHT - Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka publikuar raportin e auditimit të performancës "Ndikimi i investimeve kapitale në zvogëlimin e humbjeve të ujit dhe zgjerimin e shërbimeve të ujit te qytetarët nga KRU-të" për periudhën 2019-2021. Auditimi ka konstatuar se procesi i planifikimit, realizimit dhe monitorimit të investimeve kapitale nga Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit (KRU-të) dhe Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU) nuk është menaxhuar mirë duke ndikuar që objektivat e synuara të mos arrihen me kohë dhe në mënyrë të duhur. Planifikimi i investimeve kapitale nga KRU-të është përcjell me disa mangësi si: mungesa e Planit të Menaxhimit të Aseteve dhe Planit Afatgjatë të Investimeve; mungesa e arsyeshmërisë së qëndrueshme të investimeve; mungesa e prioritizimit të projekteve; si dhe mosharmonizimi i Biznes Planit Rregullator dhe Planit të Biznesit. Rezultatet e auditimit tregojnë

se humbjet e ujit janë evidente dhe rezultojnë me humbje financiare. Problemi i humbjeve të ujit për shkaqe teknike dhe kyçjeve ilegale si dhe vlerat e ujit të pafaturuar mbeten ende sfidë. Edhe pse kishte një zvogëlim të lehtë të humbjes së ujit, humbja mesatare e ujit gjatë vitit 2021 ishte 55 për qind.

Në raport theksohet se dështimi i realizimit të projekteve të planifikuara dhe mosadresimi i humbjeve të ujit dhe ripërtrijës së infrastrukturës, ka ndikuar që tarifat e qytetarëve për investimet kapitale të mos përdoren në mënyrë të duhur. Çështje kritike mbetet monitorimi i joadekuat i investimeve kapitale në Kompanitë Rajonale të Ujit, duke paraqitur reziqe në menaxhimin dhe realizimin e projekteve. Njëkohësisht edhe zgjerimi me shërbime të ujit dhe trajtimi i ujërave të ndotura nëpër zonat e shërbimit nga KRU-të vazhdon të përcillet me probleme dhe me një performancë të dobët dhe për këtë qytetarët në zona të caktuara nuk marrin shërbime të ujit.



Lidhur me këtë auditim, Auditorja e Përgjithshme, Vlora Spanca, ka vlerësuar se veprime konkrete duhet të ndërmerren nga Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit dhe Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit për përmirësimin e procesit të planifikimit, realizimit dhe monitorimit të investimeve kapitale.

Spanca ka deklaruar se mungesa e planifikimit të bazuar në nevoja dhe arsytim të hollësishëm ka rezultuar me mangësi në prioritizimin e investimeve në sektorin e ujërave dhe, për pasojë, ka pasur vonesa dhe dështime në realizimin e projekteve si dhe shfrytëzim joefektiv të tarifave të qytetarëve. Me qëllim të përmirësimit të procesit të planifikimit, realizimit dhe monitorimit të investimeve kapitale, Zyra Kombëtare e Auditimit ka dhënë 16 rekomandime, prej tyre 11 për Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit, katër për Autoritetin Rregullator për Shërbimet e Ujit si dhe një rekomandim për Ministrinë e Ekonomisë.

mirësimit të procesit të planifikimit, realizimit dhe monitorimit të investimeve kapitale, Zyra Kombëtare e Auditimit ka dhënë 16 rekomandime, prej tyre 11 për Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit, katër për Autoritetin Rregullator për Shërbimet e Ujit si dhe një rekomandim për Ministrinë e Ekonomisë.

ATK-ja verifikon mallrat pa origjinë

PRISHTINË, 10 GUSHT - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ua ka rikujtuar të gjithë tatimpaguesit, të cilët kanë mallra pa origjinë. "Secili tatimpagues duhet ta ofrojë dokumentacionin mbështetës, i cili arsyeton prejardhjen e mallit si në vendndodhjen, apo vendndodhjet e tatimpaguesit, ashtu edhe për mallrat në qarkullim jashtë vendndodhjes së tatimpaguesit. Po ashtu, secili tatimpagues duhet t'i dokumentojë të gjitha mallrat nga koha e pranimit (qoftë përmes importimit, blerjes, shkëmbimit apo mënyrave të tjera) derisa ato të jenë shitur apo ndryshe të jenë sistemuar,

ATK-ja ka bërë me dije se aktivitetet e saj në vazhdimësi do të përqendrohen pikërisht te tatimpaguesit, të cilët kanë mallra pa origjinë. "Secili tatimpagues duhet ta ofrojë dokumentacionin mbështetës, i cili arsyeton prejardhjen e mallit si në vendndodhjen, apo vendndodhjet e tatimpaguesit, ashtu edhe për mallrat në qarkullim jashtë vendndodhjes së tatimpaguesit. Po ashtu, secili tatimpagues duhet t'i dokumentojë të gjitha mallrat nga koha e pranimit (qoftë përmes importimit, blerjes, shkëmbimit apo mënyrave të tjera) derisa ato të jenë shitur apo ndryshe të jenë sistemuar,



përfshirë dokumentacionin e shitjes apo sistemim tjetër", ka njoftuar ATK-ja.

ATK-ja i inkurajon të gjithë tatimpaguesit t'u përgjigjen në mënyrë të saktë detyrimeve

tatimore, në të kundërtën ATK-ja do të detyrohet të ndërmarrë masa ndëshkuese sipas legjislacionit tatimor. "Me kryerjen e detyrimeve tuaja tatimore, ju do të kontribuoni

direkt në financimin e programeve qeveritare siç janë: ofrimi i shërbimeve publike, arsimim me standarde të larta, mirëqenies shëndetësore dhe sociale,

mbrojtje ligjore dhe siguri, si dhe infrastrukturë të përgjithshme për një mirëqenie më të mirë ekonomike dhe shoqërore", ka njoftuar ATK-ja.




Minatorët e ndërmarrjes "Trepça" hyjnë në grevë

PRISHTINË, 10 GUSHT - Minatorët e ndërmarrjes "Trepça" kanë hyrë në grevë të enjten. Lajmin e ka konfirmuar për "Telegrafi"-n nënkryetari i Sindikatës së Minatorëve, Destan Kërleshi, i cili ka bërë me dije se protesta ka nisur

shkaku i mosekzekutimit të pagave të muajit korrik. "Protesta ka nisur me ndërrimin e parë të minatorëve si rrjedhojë e mosrealizimit të pagës për muajin korrik. Tash po presim ndërrimin e dytë nëse do të vazhdojë apo jo grevë. Minatorët

kanë kërkuar nga kryeshefi për ta shpjegua arsyen, por ai s'ka dalë para tyre", ka thënë Kërleshi. Minatorët në Mitrovicë patën hyrë në grevë edhe një muaj më parë, në korrik, për mosekzekutimin e pagës të muajit qershor.



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Prishtina, ndeshjen me Feronikelin dhe Malishevën i luan në Hajvali

Prishtinë, 10 gusht (ER) - Skuadra më e trofeshme në vend, FC Prishtina, ka konfirmuar se dy ndeshjet e para si vendas, atë me Feronikelin (java e parë) dhe ajo me Malishevën (java e

tretë), do të luhet në fushën në Kampin Nacional në Hajvali. Ky ndryshim ka ardhur pasi fusha e stadiumit "Fadil Vokrri" është duke u bërë gati për ndeshjet e Kombëtares së Kosovës që i luan në muajin

shtator. "Dy ndeshjet e para të kampionatit, java e parë me Feronikelin dhe java e tretë me Malishevën, skuadra jonë do t'i zhvillojë në Hajvali në Kampin Nacional. FC Prishtina ka pranuar këtë akt për t'i

mirëkuptuar ndeshjet kualifikuese të Kosovës për muajin shtator. Ndeshja e javës së parë me Feronikelin zhvillohet këtë të shtunë më 12 gusht nga ora 17:00", ka njoftuar FC Prishtina.



Ademi në Podujevë: Kënaqësi të shihja dashamirë të futbollit

PODUJEVË, 10 GUSHT (ER) - Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, ka qenë mysafir në turneun e verës të mbajtur në sheshin "Ali Ajeti". Turneu kishte një pjesëmarrje masive të tifozëve, derisa numri një i futbollit, Agim Ademi, ka thënë se kjo ngjarje e veçantë është zhvilluar edhe falë mbështetjes së FFK-së në kuadër të programit për zhvillimin e futbollit spontan apo futbollit të rrugës. "Në një mbrëmje emocionuese isha pjesë e ndeshjeve finale të turneut të verës kushtuar diasporës, i organizuar në sheshin 'Ali Ajeti' në qytetin e

Podujevës. Kjo ngjarje e veçantë u zhvillua edhe falë mbështetjes së FFK-së në kuadër të programit për zhvillimin e futbollit spontan apo futbollit të rrugës. Bashkë me kryetarin e kësaj komune, Shpejtim Bulliqi, ndoqëm me kujdes dhe kureshtje këtë spektakël futbollit, e ku shumë të rinj shfaqën talentin dhe pasionin e tyre ndaj lojës më të popullarizuar në botë. FFK-ja do të vazhdojë t'i përkrahë aktivitetet e tilla dhe promovimin e futbollit dhe mundësive që ai i ofron për zhvillimin e të rinjve", ka shkruar Ademi në "Facebook".



'Epoka Abramoviq' lë Chelsean me pasoja! Pas gjobës nga UEFA, rrezikohet edhe heqja e pikëve



LONDËR, 10 GUSHT - Premierë Liga është duke e hetuar Chelsean për shkelje të mundshme të rregullave financiare gjatë pronësisë së klubit nga Roman Abramoviq. Pronarët e rinj të Chelseas kanë raportuar klubin e tyre në UEFA dhe Premierë Ligë pas blerjes së aksioneve të tyre verën e kaluar. Aktualisht Chelsea nuk është akuzuar për asgjë nga Premierë Liga, por nëse ndaj saj ngrihen akuza dhe nëse shpallet fajtorë për shkelje të rregullave, sanksionet mund të përfshijnë një gjobë ose një zbritje pikësh. Më 28 korrik UEFA ka njoftuar

se e kishte gjobitur Chelsean me 10 milionë euro (8.6 milionë paund) për "dorëzimin e informacionit financiar jo të plotë" mes viteve 2012 dhe 2019. Pasi është kontaktuar nga "Sky Sports News", Chelsea ka zgjedhur që të mos komentonte. Abramoviqi e kishte blerë klubin në vitin 2003 për 140 milionë paund, me Chelsean që kishte fituar vetëm një titull kampion në vitin 1955, Kupën e Kupave më 1971 dhe tri Kupa FA midis 1970 dhe 2000. Por investimi i miliardërit rus ka rezultuar në pesë tituj Premierë Lige, pesë Kupa FA, tri Kupa të Ligës, dy

Liga të Kampioneve, dy Liga Evrope, dy Superkupa Anglie dhe një Superkupë Evrope. Trofeu i fundit që blutë e Londrës e kanë fituar nën drejtimin e Abramoviqit ishte Kupa e Botës për Klube në shkurt 2022, e cila ka ardhur vetëm një muaj para se rusi ta shiste klubin pas vendosjes së sanksioneve nga qeveria britanike për shkak të luftës Rusi - Ukrainë. Investitori Tod Bohli ka marrë drejtimin e klubit në verën e vitit 2022, me Chelsean që përfundoi i 12-ti në renditjen e Premierë Ligës në sezonin e parë të amerikanit në krye.

Mbappe i befason të gjithë, do të qëndrojë në Paris!

Paris, 10 gusht - Kylian Mbappe i ka befasuar të gjithë me vendimin e tij më të ri. Njëjtë si vitin e kaluar, sulmuesi francez duket se e ka ndërruar mendjen dhe ka vendosur të qëndrojë në Paris Saint-Germain (PSG). Për këtë ka siguruar mediumi francez "Le Parisien". Gjithnjë sipas këtij mediumi, 24-vjeçari

do ta respektojë kontratën e tij deri në vitin 2024, e më pas të largohet si lojtar i lirë. Natyrisht, ish-futbollisti i Monacos nuk do të pranojë ta vazhdojë kontratën deri në vitin 2025, ose do ta vazhdojë, por me kusht që do të ketë të drejtë të largohet vitin tjetër. Siç dihet, ëndërr e përfaqësuesit francez është

transferimi në Real Madrid, i cili kështu mund të shtyhet për një vit tjetër. Parisienët deri sot ishin të gatshëm ta shisnin futbollistin "e rebeluar" për 200 milionë euro, ndërsa kishin marrë ofertë nga Arabia Saudite, por atë e donin edhe klubet angleze, Liverpool, Arsenal dhe Chelsea.





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Zveçanit
Opština Zvečan - Municipality of Zvečan



Datë: 10.07.2023

Në bazë të nenit 67,68 dhe 69 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyratë Publike, nenit 5, pikës c. Të Ligjit Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212, të Punës, Udhëzimit Administrativ (MASHTI) Nr. 05/2021 për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, Udhëzimit Administrativ 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Komuna e Zveçanit, shpall

KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË PUNËS

Nr.	Niveli	Pozita	Vend i lirë /Zëvendësim	Numri i pozitave
1	SHFMU	Mësimdhënës/e, lënda Fizikë	Vend i lirë	1
2	SHFMU	Mësimdhënës/e, lënda Gjuhë shqipe	Vend i lirë	1
3	SHFMU	Punëtor teknik (pastrues)	Vend i lirë	1

I. Dokumentacioni i nevojshëm për konkurrim

- Formulari i aplikimit (merret në SHF "ISA BOLETINI" P.N Lipë)
- Diploma (Certifikata e diplomimit – nuk duhet të jetë më e vjetër se gjashtë muaj) e fakultetit e fotokopjuar dhe e noterizuar nga organi kompetent;
- Ekstrakti i lindjes;
- Letërnjoftimi i fotokopjuar;
- Vërtetimi nga gjykata se aplikuesi nuk është në procedurë të hetimeve, apo i dënuar për veprë penale;
- Dokumenti i përvojës së punës në arsim (nëse ka)
- Me rastin e themelimit të marrëdhënies së punës, punëtori/ja është e detyruar të sjellë certifikatën e gjendjes shëndetësore.

II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve

Përzgjedhja e kandidatëve për mësimdhënës do të bëhet në bazë të kriterëve të paracaktuara me aktet juridike të lartshënuar.

Në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2021 për Normativën mbi kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, kandidatët për të konkuruar për këtë pozitë duhet t'i plotësojnë këto kriteret të kualifikimit:

- Niveli master arsimor (300 ECTS)
- Sistemi katërvjeçar;
- Bachelor (katërvjeçar 240 ECTS)

Vërejtje: Sipas pikës 3 të nenit 11 për Kualifikimet e Mësimdhënësëve, në Udhëzimin Administrativ (MASHTI) Nr. 05/2021 për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, qartësohet se: " Të gjithë të kualifikuarit në njësitet akademike që kanë përfunduar master arsimor 300ECTS, sistemin katërvjeçar (profesor) dhe bachelor katërvjeçar 240 ECTS, kanë të drejtë të barabartë konkurrimi në arsimin parauniversitar të paraparë me nenin 6 dhe 7 të këtij udhëzimi"

Kandidatët me kualifikime jo përkatëse dhe ata të pakualifikuar sipas këtyre ligjeve UA nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.

Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet t'i kenë të nostrifikuara diplomat nga MASHITI. Pas plotësimit të dispozitivave ligjore dhe kriterëve të konkursit publik, kandidatët do t'i nënshtrohen testimit me shkrim

Në test me shkrim do të ftohen ata kandidat të cilët i plotësojnë kushtet sipas akteve ligjore të lartcekura.

Lista e ngushtë e aplikantëve për test, intervistë, si dhe orari i intervistave bëhet nëpërmjet email-it dhe përmes telefonit (sipas të dhënave në aplikacionin e kandidatit/es).

Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

III. Afati dhe mënyra e aplikimit

Aplikacioni i kompletuar (me të gjitha dokumentet e kërkuara) duhet të dorëzohet në Zyren për komunitete, fsh.Lipë.

Dokumentet e dërguara pas afatit nuk do të shqyrtohen.

Afati i aplikimit është 15 ditë. Data e njoftimit në faqen: konkursi.rks-gov.net është prej datës 07.08.2023 deri me datë 05.09.2023, ndërsa data e aplikimit është nga data 06.09.2023 deri me datën 20.09.2023.

Drejtorja e arsimit



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Opština Zvečan

Komuna e Zveçanit - Municipality of Zvečan

Datum: 10.07.2023

Na osnovu člana 67, 68 i 69 Zakona br. 06/L-1 14 o Javnim Službenicima, člana 5, tačka (c) Zakona br. 03/L-068 o Obrazovanju u opštinama Republike Kosovo, Zakona br. 04/L-032 o pred univerzitetskom obrazovanju u Republici Kosovo, člana 8 Zakona br. 03/L-212 o Radu, Administrativnog Uputstva (MONT) br. 05/2021 o Normativu stručnog kadra opšteg obrazovanja, Administrativnog Uputstva 07/2017 o Regulisanju Procedura Konkursa U Javnom Sektoru, opština Zvečan objavljuje:

KONKURS ZA POPUNJAVANJE RADNOG MESTA

Br.	Nivo	Pozicija	Upraznjeno mesto / zamena	Broj pozicija
1	NSOŠ	Nastavnik Fizike	Upraznjeno mesto	1
2	NSOŠ	Nastavnik Albanskog jezika	Upraznjeno mesto	1
3	NSOŠ	Tehnički radnik (čistač)	Upraznjeno mesto	1

I. Dokumentacija potrebna za konkurisanje:

- Formular za prijavu (uzima se u OS „Isa Boljetini“ IO u Lipi);
- Diploma (Uverenje o diplomiranju – ne starije od šest meseci) fakulteta, kopirana i overena od strane relevantnog organa;
- Izvod iz matične knjige rođenih;
- Fotokopija lične karte;
- Potvrda iz suda da aplikant nije pod istragom ili kažnjen za krivično delo;
- Dokument o radnom iskustvu u obrazovanju (ukoliko ima);
- Prilikom zasnivanja radnog odnosa, radnik je dužan do donese zdravstveno uverenje

II. Uslovi i kriterijumi za izbor kandidata

Izbor kandidata za nastavnik za nastavnik vršiće se na osnovu kriterijuma definisanih navedenim zakonskim aktima.

Na osnovu Administrativnog uputstva br. 05/2021 o Normativu stručnog kadra opšteg obrazovanja, kandidati koji će konkurisati za ovu poziciju moraju ispuniti sledeće kriterijume kvalifikovanja:

- Master obrazovni nivo (300 ECTS);
- Četvorogodišnji sistem;
- Bachelor (četvorogodišnji 240 ECTS)

Napomena: Prema tački 3 člana 11 o kvalifikaciji nastavnika, u Administrativnom Uputstvu (MONTI) br. 05/2021 o Normativu stručnog kadra opšteg obrazovanja, pojašnjava se da: „ Svi kvalifikovani u akademskim jedinicama koji su završili master u obrazovanju 300 ECTS, četvorogodišnji sistem (profesor) i četvorogodišnji bachelor 240 ECTS imaju jednako pravo da konkurisu u preduniverzitetskom obrazovanju predviđeno u članu 6 i 7 u ovom Administrativnom uputstvu"

Kandidati sa neadekvatnim kvalifikacijama i oni koji nisu kvalifikovani prema ovim zakonima AU, neće biti razmotreni odnosno biće odbijeni.

Osobe koji su diplomirali van Kosova moraju imati svoje diplome overene od strane MONTI. Nakon ispunjenja zakonskih odredbi i kriterijuma javnog konkursa kandidati će podvrgnuti pismeni test.

Na pismeni ispit biće pozvani kandidati koji ispunjavaju uslove prema navedenim zakonskim aktima.

Uži spisak kandidata za testiranje, intervju, kao i raspored intervjuja izvršiće se putem mejla i telefonom (prema podacima u prijavi kandidata).

Sva dokumenta se predaju u kopiji overena od strane notara (koja se ne vraćaju). Originalna dokumenta se mogu tražiti prilikom intervjuja.

III. Rok i način prijave

Popunjavanje prijave (uz svu traženu dokumentaciju) mora se podneti u kancelariji za zajednice u selo Lipa.

Dokumenti poslati nakon isteka roka neće se razmatrati.

Rok za prijavu je 15 dana. Datum obaveštenja na stranici konkursi.rks-gov.net je od dana 07.08.2023 do 05.09.2023, a datum za prijavu je od dana 06.09.2023 do 20.09.2023.

Direkcija prosvete



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Zveçanit
Opština Zvečan – Municipality of Zvečan

Datë: 09.08.2023

Në bazë të nenit 67,68 dhe 69 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenit 5, pikës c. Të Ligjit Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet dhe Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L=212, të Punës, Udhëzimit Administrativ (MASHTI) për detyrat, përgjegjësitë, procedurat dhe kriteret e zgjedhjes së drejtorit të institucionit edukativo-arsimor, Komuna e Zveçanit, shpall

KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË PUNËS

Nr.	Niveli	Pozita	Vend i lirë /Zëvendësim	Numri i pozitave
1	SHFMU	Drejtor	Vend i lirë	1

I. Dokumentacioni i nevojshëm për konkurim

- Formulari i aplikimit (merret në zyrë për komunitete-Lipë)
- Diploma (Certifikata e diplomimit – nuk duhet të jetë më e vjetër se gjashtë muaj) e fakultetit e fotokopjuar dhe e noterizuar nga organi kompetent;
- Ekstrakti i lindjes;
- Letërnjoftimi i fotokopjuar;
- Vërtetimi nga gjykata se aplikuesi nuk është në procedurë të hetimeve, apo i dënuar për vepër penale;
- Dokumenti i përvojës së punës në arsim (nëse ka)
- Me rastin e themelimit të marrëdhënies së punës, punëtori/ja është e detyruar të sjellë certifikatën e gjendjes shëndetësore.

II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve

- Te jete shtetas i Republikës së Kosovës
- Te kete kryer arsimin universitar, nivelet e kualifikimit qe i plotesojne kushtet sipas normativit profesional per arsim te pergjithshem dhe normativit per arsim profesional ne fuqi.
- Master per udheheqje, administrim ose menaxhim ne arsim
- Master arsimor(kualifikimin prej 300 ECTS/ 5 vite te shkollimit universitar)
- Te kete licence te rregullte te mesimdhensit sipas udhezimit per licencim te mesimdhenseve
- Te kete pervojë pune ne procesin edukativo arsimor

Udhëzime për përgatitjen e portfolios profesionale

- Biografine e shkurter
- Konceptin e Planit Zhvillimor te institucioneve edukativo-arsimore, bazuar ne pese fushat e cilesise se performances se shkolles
- Certifikatat qe deshmojne perfundimin e programeve te zhvillimit profesional ne fushen e administrimit, menaxhimit dhe udheheqjes
- Leter motivuese
- Deshmi nga pervoja paraprake ne menaxhim
- Leter reference me permbajtje deshmuese per punen dhe angazhimet paraprake.

Vërejtje: Sipas pikës 3 të nenit 11 për Kualifikimet e Mësimdhënësëve, në Udhëzimin Administrativ (MASHTI) Nr. 05/2021 për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, qartësohet se: “ Të gjithë të kualifikuarit në njësitë akademike që kanë përfunduar master arsimor 300ECTS, sistemin katërvjeçar (profesor) dhe baçelor katërvjeçar 240 ECTS, kanë të drejtë të barabartë konkurrimit në arsimin parauniversitar të paraparë me nenin 6 dhe 7 të këtij udhëzimi ”

Kandidatët me kualifikime jo përkatëse dhe ata të pakualifikuar sipas këtyre ligjeve UA nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.

Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet ti kenë të nostrifikuarat diplomat nga MASHTI. Pas plotësimit të dispozitave ligjore dhe kriterëve të konkursit publik, kandidatët do t'i nënshtrohen testimit me shkrim

Në interviste do të ftohen ata kandidat të cilët i plotësojnë kushtet sipas akteve ligjore të lartcekura.

Lista e ngushtë e aplikantëve intervistë, si dhe orari i intervistave bëhet nëpërmjet email-it dhe përmes telefonit (sipas të dhënave në aplikacionin e kandidatit/es).

Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

III. Afati dhe mënyra e aplikimit

Aplikacioni i kompletuar (me të gjitha dokumentet e kërkuara) duhet të dorëzohet në Zyren për komunitete, fsh.Lipë.

Dokumentet e dërguara pas afatit nuk do të shqyrtohen.

Afati i aplikimit është 15 ditë. Data e njoftimit në faqen: konkursi.rks-gov.net është prej datës 07.08.2023 deri me datë 05.09.2023, ndërsa data e aplikimit është nga data 06.09.2023 deri me datën 20.09.2023.



NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Nika Compani” SH.P.K. me seli në Vushtrri, pronar Adnan Nika, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811940099 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Nika Compani” D.O.O. Vushtrri, sa vllasnikom Adnan Nika, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812049949 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Nika Compani” L.L.C. with headquarters Vushtrri, with owner Adnan Nika, has come to the decision to quit its business: 812049949 the company has appointed a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Co&Remi” SH.P.K. me seli në Gjilan, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811849910 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Co&Remi” D.O.O. Gnjilane, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811849910 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Co&Remi” L.L.C. with headquarters Gjilan, has come to the decision to quit its business: 811849910 the company has appointed a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

